

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike

Vëllimi III

Përgatitën botimin:

Shaban Sinani
Pëllumb Xhufi

Tiranë, 2024

Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike

Vëllimi III

Përgatitën botimin:

Shaban Sinani
Pëllumb Xhufi

Aktet e Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike botohen
nën kujdesin e akad. **Skënder Gjinushi**, Kryetar i Akademisë së
Shkencave

Tiranë, 2024

Titulli:

Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike, vëllimi III

Përgatitën botimin:

Shaban Sinani Pëllumb Xhufi

Redaktore gjuhësore:

Bruna Prifti

Redaktore teknike:

Enkelejda Misha

Copyright: Akademia e Shkencave e Shqipërisë

ISBN 978-9928-339-71-3 (Kolana)

ISBN 978-9928-809-23-0 (Vol.3)

Shtypur në shtypshkronjën “Filara”

Tiranë, 2024

Komiteti i nderit:

Akad. Ismail Kadare, bashkëkryetar; Akad. Francesco Altimari, bashkëkryetar;
 Akad. Rexhep Ismajli, bashkëkryetar; Akad. Luan Starova, bashkëkryetar;
 Akad. Rexhep Qosja, bashkëkryetar; Akad. Muzafer Korkuti, anëtar;
 Akad. Edi Shukriu, anëtar; Akad. Peter Schreiner, anëtar; Akad. Johannes Koder, anëtar; Akad. Peter Bartl, anëtar; Akad. Titos Jochalas, anëtar; Akad. Pierre Cabannes, anëtar; Prof. dr. Brian Joseph, anëtar;
 Prof. dr. Alexander Rusakov, anëtar; Prof. dr. Irena Sawicka, anëtar; Prof. dr. Lucia Nadin, anëtar;
 Prof. dr. Petya Assenova, anëtar;
 Akad. Răzvan Theodorescu, anëtar;
 Prof. dr. Noel Malcolm, anëtar;
 Prof. dr. Aleksandër Mexsi, anëtar;
 Prof. dr. Zheng Engbo, anëtar.

Komiteti shkencor:

Akad. Pëllumb Xhufi, bashkëkryetar (ASHSH);
 Akad. Eqrem Basha, bashkëkryetar (ASHAK);
 Akad. Ethem Likaj, anëtar;
 Akad. Sabri Hamiti, anëtar;
 Akad. Kujtim Shala, anëtar;
 Akad. Jusuf Bajraktari, anëtar;
 Prof. dr. Neritan Ceka, anëtar;
 Prof. dr. Sabri Laçi, anëtar;
 Prof. dr. Valter Memisha, anëtar;
 Akad. Shaban Sinani, anëtar;
 Akad. asoc. Kristina Jorgaqi, anëtar.

Komiteti organizues:

Akad. Skënder Gjinushi, bashkëkryetar;
 Akad. Mehmet Kraja, bashkëkryetar;
 Prof. dr. Artan Hoxha, anëtar;
 Akad. Marenglen Verli, anëtar;
 Prof. dr. Skënder Topi, anëtar;
 Prof. dr. Suzana Golemi, anëtar;
 Akad. Eqrem Basha, anëtar;
 Akad. Ali Aliu, anëtar;
 Akad. Kujtim Shala, anëtar;
 Prof. dr. Lindita Rugova, anëtar;
 Prof. dr. Hysen Matoshi, anëtar.

Tryeza e lëndës

Andrea Di Giuseppe (Itali)

Tibi dabo claves: una deisis con Pietro e Paolo e la liminalità rituale in Albania nel XIV sec.7

Karl Hammer (Gjermani)

Albania at the crossroads of cultivated Plants56

Skënder Muçaj, Suela Xhyheri

Kastriotët dhe fisnikët e tjerë arbërorë në fushën e ndërtimeve mbrojtëse dhe kishtare në shek. XII-XV69

Ioannis Vitaliotis (Greqi)

Lëndë ikonografike që lidhen me Kryepeshkopatën e Ohrit në pikturën kishtare bizantine dhe pasbizantine (shek. XIV-XVII) në Shqipëri108

Ferit Duka

Realitete osmane në Shqipërinë e Jugut: vendbanimet dhe popullsia në kazanë e Gjirokastrës gjatë shek. XVI135

Ledia Dushku

Veprimtaria e arbëreshëve të Italisë në optikën e dokumentacionit austro-hungarez (1895-1897)162

Dorian Koçi

Simbolet europiane të Ali pashë Tepelenës: heraldika186

Cătălina Vătășescu (Rumani)

Shtresa etimologjike në leksikon e zakoneve juridike shqiptare. Fjalët e urta të Kanunit të Lekë Dukagjinit.....200

Artur Karasiński (Poloni)

Polifunksionaliteti i prapashtesës -ës[ø] në sistemin fjalëformues të gjuhës moderne shqipe.....225

Aleksandër Novik, Dmitrij Zenjuk, (Rusi)

Arnautët e Azovit: historia, gjuha dhe kultura tradicionale233

Valbona Toska (Maqedoni e Veriut)

Ngarkesa funksionale e trajtave të shkurtra në gjuhën shqipe249

Zamira Shkreli, Bora Logu

Natyra e fjalisë së përbërë në gjuhën shqipe sipas sintaksologut Át Justin Rrota256

Rigels Halili (Poloni)

Këngët kreshnike dikur dhe sot – një vështrim nga pikëpamja e teorisë së oralitetit263

Blerina Suta (Itali)

Miti ovidian i “Gjenezës” në interpretimin dygjuhësh të Bogdanit278

Eldon Gjika

“Parime të estetikës” së De Radës dhe estetika e romantizmit302

Albert Doja (Francë)

Vështrim antropologjik mbi studimet shqiptare307

Arian Leka

Nënshtresa mistike në krijimtarinë e Hamid Gjylbegut – vendtakim i origjinave të besimeve fetare, politike e filozofike të Lindjes e Perëndimit334

Agim Vinca

Poezia shqipe (1945-1990), fazat e zhvillimit dhe tipat e ligjërimit362

Iljaz Rexha

Prania e popullsisë albane në hapësirën gjeografike të Dardanisë-Kosovës dhe Maqedonisë Veriperëndimore gjatë mesjetës, para pushtimit të Ballkanit nga Perandoria Osmane (sipas burimeve sllave të shek. XIII-XIV dhe osmane-turke të shek. XV-XVI)384

Jani Koçillari

Aleksandër Molosi, “mbrojtësi i Magna Grecia-s” (viti 334/333 p.Kr. – 331/330 p.Kr.)426

Blerina Suta

Università di Napoli 'L'Orientale'

Miti ovidian i “Gjenezës” në interpretimin dygjuhësh të Bogdanit*

1. Parashtrësë për mitin e Zanafillës në veprën e Bogdanit

Procesi i rilindjes identitare (në radhë të parë asaj gjuhësore), funksion i veprimtarisë krijuese të Bogdanit, vjen jo vetëm prej ‘kujdesit rilindës’ që autori i *Cuneus Prophetarum* ka shprehur për shqipen (Omari: 2020), por dhe falë një cilësie shtesë (*polisense*¹) që përmasa ‘letrare’ e tekstit të tij ka ditur të rrezatojë te lexuesi i së ardhmes.

Funksioni artistik në brendi të një teksti si *Cuneus*, i shtresëzuar (veç teksteve biblike të Dhjatës së Vjetër dhe asaj te Re përdoren edhe fragmente që gërshetojnë filozofinë, letërsinë mitologjike, poezinë, traktatin mjekësor etj.), është rezultat i përdorimit me funksion të caktuar të zërave të ndryshëm të traditës klasike që i japin asaj një ngjyresë letrare dhe humaniste.

Rruga e të diturve (“La strada dei sapienti” (Bogdani&Sedaj 1998: 537²), atyre të deklaruar (kritika ka numëruar 34) dhe të padeklaruar, e ndihmojnë Bogdanin që, në takimin e shqipes me italishten, të synojë rrafshin më të lartë të funksionit letrar në shërbim të krijimit të koinesë letrare të shqipes.

*Falenderoj Prof. dr. Anila Omarin për këshillat dhe materialet në ndihmë të këtij punimi.

¹ *Polisensi* është kategori e cilësisë së tekstit letrar i cili falë marrëdhënieve mes elementeve të substancës së shprehjes dhe substancës së përmbajtjes, realizon fuqizimin kuptimor semantik apo progresin e brendshëm të domethënieve të zakonshme, në domethënie të pazakonshme, në të vërteta të shkallës më të lartë. Shih, Della Volpe G. (1966), f. 106.

² Bogdani&Sedaj (1998), f. 537. [*Quis ille stylus? Quid in eo ingenii? Ille commentator mera Rapsodia, de charta in papyrum.* “çfarë është ajo pendë? çfarë vetie natyrore gjindet në të? Ajo është shpjegues i këngës së vërtetë, nga shkrimi në letër”.

Modeli i Zanafillës në kornizë të veprës është ai bibliik, që citohet drejtpërdrejt në incipit të shkallëve IV e V me vargjet latinisht të “Gjenezës” dhe që kompletohen me citime të tjera, të cilat u paraprijnë gjashtë ditëve të krijimit.

Ky mit bibliik që përfshin shkallën e parë, është dhe ndër më të shtresëzuarit nga strukturat figurative të miteve pagane (krijimi i qiellit, i tokës, i njeriut), mite të traditës mesdhetare, të cilat përdoren nga autori me një funksion stilistik tipik të tekstit artistik.

Ndonëse modeli mitologjik i krijimit është model universal që njih variante të ndryshme në të gjitha kulturat e botës, historia e kulturës europiane flet për përdorim të këtij miti gjerësisht, si në modelet jo letrare (filozofike e shkencore), ashtu dhe në modelet poetiko-letrare si dhe ato figurative (pikturës, skulpturës).

Boitani në kapitullin “Principio-Creazione” të veprës së tij “Guida allo studio delle letterature comparate” (Boitani, P. & Di Rocco E.: 212-227) merr në konsideratë historinë e mitit nga pikëpamja e modelit shkencor (filozofik), poetik dhe figurativ, veç atij bibliik: shkasi i parë i universit është në themel të filozofisë natyrore (“Metafizika” e Aristotelit e thotë se “me emrin e dijes (sophía) nënkuptohet kërkimi i shkaqeve të para e të zanafillave”).

Në kulturën europiane, vepra mitologjiko - poetike që përpunon mitin e krijimit (Zanafillës) me jehonë më të madhe në shekujt në vazhdim është “Metamorfozat” e Ovidit¹. Origjinaliteti i përshkrimit ovidian ku *Zanafilla* dhe *Krijimi* përputhen, qëndron sidomos në përshkrimin e kaosit, bashkim të kundërtash në *Zanafillë*, deri në ndërhyrjen e një zoti (deus), e një natyre më të mirë (melior natura) e cila i ndan, i sistemon dhe i jep një vend të saj in çdo gjëje që më së fundi merr formë, për t’u populluar me qenie të gjalla dhe për të kulmuar me njeriun, më fisnikun e qenieve, më të denjin për një intelekt të lartë.

‘Fati’ letrar i kaosit të Ovidit, simbol tipik i kulturës mesdhetare, është rrezatuar në traditën perëndimore deri në modernitet: qysh nga Dante (i cili sipas Boitanit ka një “pasion të vërtetë për temën e Zanafillës dhe Krijimit, më të cilin hap dhe mbyll *Komedinë*”, te Mikelanxhelo (i cili “ka konceptuar fazat fillestare (primordiale) të

¹ Boitani P. & Di Rocco E. (2013), shih për më tepër kapitullin “Mitto, letteratura storia”, ed. e-book.

Krijimit si një betejë elementesh, mes dritës dhe errësirës, që e shtyn zotin në një “zhytje të pazakontë në lëndën plot ngërç që po nis të ndajë”) e deri në krijimet baroke (me katër vepra të mëdha poetike të lidhura me krijimin dhe Gjyqin (Maurice Scève- *Microcosme*; Guillaume Salluste Du Bartas - *La Sepmaine, ou Création du Monde*, Il Tasso - *Mondo creato*, botuar rreth 1600 dhe 1607, dhe në Spanjë, Alonso de Acevedo - *De la Creación del Mundo*, 1615). (Boitani, P. & Di Rocco E., 2013: 230-235).

Për t’u kthyer tek autori ynë, modeli i Zanafillës në kornizë të veprës është ai biblik, që siç dihet, ndryshe nga modeli mitologjik karakterizohet nga roli qendror i figurës së Krijuesit, si shkas fillestar primar dhe i drejtpërdrejtë, i cili e sendërton në gjashtë faza botën nga hiçi, pas një aktiviteti ndarjeje e sistemimi të elementeve përbërëse: ditës nga errësira, ujërave përmbi firmament nga ato poshtë tij; vendosjes së emrave (dita, qielli etj.).

Bogdani, këtë akt unik të Zotit, të zanët fill/ il “principio” e përshkruan si një akt hyjnor, “con un solo fiat - ab eterno”:

“*Talmente che Dio onnipotente, come dice il Sacro Testò [të shkruemitë shent’], fino dal principio in sei giorni creò il Cielo , e la Terra con un sol fiat// krijoj qiellnë e dhenë me një të vetëme fjalë: bâftu*” (Cuneus: I.IV.4).

Nga një shfletim i “Fjalorit” të Cuneus-it (Omari 2016), përdorimi i termave (krijuem/ “creare”; (të) krijuesit/ “creazione”; krijues/ “creatore”; Krijues’/ (il) “creatore”) bëhet ekskluzivisht në funksion të mitit biblik të ‘Zanafillës, që sheh zotin shkas të parë të krijimit dhe ‘verbin’ (fjalën) si vepruesen e vullnetit të zotit nga hiçi, me një “solo fiat” (fjalë të vetme/ solo con la parola “sia fatto”).

Në shkallën *Si e krijoj zotynë qiellnë* (“Come Dio creò il cielo”, I.IV.1), Bogdani bën dallimin mes *krijuem/ “creare”,* mundësi ekskluzive e Hyjit që krijon nga hiçi (*asnjiseni*) dhe dhe *lëm/ “generare”,* që i përket rrafshit johyjnor.

1. *In principio creavit Deus Caelum*
&Genesis1./

Si deve presupporre, che creare non è propriamente far d'una cosa un'altra (perche questo si chiama generar (*me leem*) mà è fare di nulla

1. *Ndë të zanët fill krijoj Hyji qiellnë,*
etc. Genes.

Duhetë me dijtunë se me krijuem nukë do me thanë një kafsheje me bëm një tjetër (përse ashtu kishinë me i thanë të lëm), por është kur asnjiseni

qualche cosa; il che è tanto proprio à Dio, che à Niuna creatura perfettissima potè essere comunicata: essendo che trà l'essere, e non essere v intercede una infinita distanza; onde è necessario un infinito potere à produrre in essere quello , che non è : questo è potere di solo Dio.

(I.IV.1 “Come Dio creò il cielo”, vv. 1-10)

bâhet gjakafshë, e silla vepërë veçë Tinëzot përket, e kurraj kreatyra nukë mundetë me krijuem, përse ndër të kjanët e moskjanët âshtë një të largë të pasosunë kurraj. Andaj duhetë një pushtet e pasosunë me nxjerrë mbë dritë qish mos âshtë, e këjo veçë âshtë vetëmë pushtetja e Tinëzot.

(*Si e krijoi Zotynë qiellnë*)

Të krijemitë/ la “creazione” në veprën e Bogdanit shënon kulmin nga pikëpamja figurativo-poetike në përshkrimin e ‘kaosit’, i cili në rrëfimin biblik ndodh fill pas krijimit nga hiçi, ndryshe nga ritmi mitologjik i paganëve/ “i Gentili” (nga të cilët Bogdani distancohet), të cilët shihnin në “Chaos/ një të përziemi” lëndën para ndërhyrjes së zotit:

2. “*Dal non conoscere Dio provenne, che li Gentili (Peganetë) mai arrivarono a credere, come fosse possibile , farsi di nulla qualche cosa, considerando, che nelle cose naturali in tutti li mutamenti vedeano, che sempre si preponeano alcune cose, di cui un'altra si faceva : onde à credetero, che il Mondo fosse stato fatto ab eterno, è dissero, che Dio è la materia prima, che essi chiamano Chaos, di che tutte le cose credeano essere state fatte*”.

I.IV 2, “Come Dio creò il cielo”, vv. 10-15

2. Përse nukë njoftinë Tënëzonë të pëganëte, andaj nukë mujtinë me mbërrim e me besuem, si munë jetë asnjiseni me u bām gjakafshë, tue vum roe se ndër punë të kësaj jetë gjithëherë gjakafsheje bâhej tjetëra. Prashtu o besonjinë se shekulli ishte jetet së jetësë, o thojnë se Zotynë âshtë sikur me thanë një landë kahë gjithë kafsha trajtohej e bâhej, e i thonë Kaos, një të përziem”

(I.IV 2, “*Si e krijoi Zotynë qiellnë*”)

Bogdani e përshkruan me një skenë poetikisht të pasur Kaosin, trajtën e përzier dhe të zbrazët të rruzullimit “*krijuem përziem*”/ “creato in confuso” në çastin fill pas ndërhyrjes së Zotit, por përpara çastit të përsosjes së krijimit hyjnor:

“In virtù del primo volere di Dio resto dunque il Mondo *creato in confuso*, poi continuando la Sua divina Maesta la sua mirabil opera// *Me urdhëni të parë të Hyjit mbet pra shekulli krijuem përziem. Ani tue ndjekunë i nalti Zot punën e vet të mrekuellenë*” (I.I.IV, 5).

Le të merremi më konkretisht me ‘burimet’ e mitologjisë pagane në tablonë bogdaniene të kaosit, me raportin e tekstit shqip me atë italisht (që Bogdani u detyrua ta paraqesë në dy kolona “posi t’ish një kalepi”), i cili nuk rezultoi, sidomos në tekstet poetiko-artistike, i njëjtë në të dyja shtyllat.

Kjo analizë lë vend për një interpretim të funksionit polisens të veprës së Bogdanit, edhe duke pasur parasysh ‘fatin’ e saj në të ashtuquajturën traditë të qarkut të predikatorëve.

2. ‘Burimi’ i “Kaosit” në veprën dygjuhëshe të Bogdanit dhe terreni fluid i dygjuhësisë

Përshkrimi i zbrazëtisë dhe përzierjes përcillet nëpërmjet vargjeve të Poetit të panjohur me “P” të madhe: *“ma non per questo ogni cosa nel suo luogo, e specie formata resto. Perché Terra erat inanis, & Vacua come il Poeta.”* / “Ma jo prashtu gjithë kafsha mbet mbaruem e mbukuruem përse dheu ishte i mbrazëtë e i përziem, posi thotë Poeta.

Vargjet e “poetit të panjohur”, dy oktava, në italisht dhe shqip, që përshkruajnë në 16 vargje Krijimin, janë bërë objekt i reflektimit të shumë studiuesve, të cilët kanë ofruar një çelës leximi të këtij teksti si një tekst që mishëron në versionin shqip metafora “edhe më të bukura” se teksti italisht (Sedaj 1991: 134¹):

¹ Sedaj E. (1991), f. 134: “[...] interes të veçantë zgjon gjithashtu edhe poezia e një “poeti” të panjohur, të cilën P. Bogdani e përkthen (në një mënyrë mjaft të lirë), duke vënë përmbajtjen e saj në lidhje me ato fjalët e Gjenezës se “dheu ishte i mbrazëtë e i përziem. (*Terra erat inanis et vacua*) [...] Në fakt, e vërteta poetike perceptohet në imagjinimin e situatave metaforike të mishëruara në ligjërimin e gjuhës shqipe, ndoshta edhe më bukur se në gjuhën italiane”.

20 Scal.I. Disc.IV.

Rea che il Ciel fosse il Mar, la
Terra, e il Foco,
Era il Foco, la Terra il Ciel, e'l
Mare,
Mà il Mar rendeva il Ciel, la
Terra, e'l Foco
Deforme: il Foco, il Ciel, la Ter-
ra, e'l Mare,
Che irvi era e Terra, e Ciel, e
Mare, e Foco,
Dove era e Cielo, e Terra, e
Foco, e Mare,
La Terra il Foco, e il Mare era
nel Cielo,
Nel Mar il Foco, e nella Terra
il Cielo,

Non vi era chi portasse il nome
giorno,
Con maggior lume in Oriente ac-
ceso,
Ne rimanesse mai la luna il Cor-
no,
Ne l'altre Stelle banean lor corso
peso,
Ne pendeva la Terra intorno in-
torno,
Librata in Aere dal suo proprio
peso:
Ne il Mar banea col suo proprio
grido,
Fatto intorno la Terra il varia
lido.

Scal.I. Lig.IV.

Arrisè Chiellja, yu, Deti, e
Ëjarmi
Iste: kje Ëjarmi, yu, Chiel-
lja, e Deti;
Ma (cepton Chiellja yu, e De-
tinè Ëjarmi;
Se kù ifc Chiellja, yu, Ëjarmi,
e Deti,
As Ëj yu, Chiellja, Deti, e
Ëjarmi;
yu Chiellne mbelson, e Ëjarmine
Deti;
Chiellja Deti ende Ëjarmi, ifste
ende yu,
yu, Ëjarmi, ende Chiellja ifste
ndè Det.

MBi Chiell' nuk' ifste, as Sll, as
Diellj,
Chi me dristèt rvet ebar yu dritte
tè rre,
As Hana delè me d8 tè rgianta
brii,
As prej chiell'it rvinte ndogni
Reçe për yu,
As yu si Schöpe mal' chendron,
e rii,
As nigalle me scii, as brescen',
as Resfèe,
As Deti me Vale epè tè mag-
giame,
As l8menatè me Bregb, ifcinè
Ëanè.

5 Mo

Përmendim fragmentin brilant të Kadaresë në “Ftesë në studio” (Kadare 2012: 185), i cili flet për mahnitjen e Rugovës prej vjershës kozmogonike të Bogdanit që e quan “Krijimi i rruzullimit” dhe tërheqjen që kanë pasur ndaj këtij teksti poeti Lasgush Poradeci, si

dhe interesin që këto vargje kanë zgjuar në punimet kritike të studiuesve Sabri Hamiti, Rexhep Qosja etj.

Gjenialitetit të Kadaresë nuk i shpëton veçantia ‘moderne’ (“kureshtare”) e teknikës poetike të Bogdanit: “dhënia e një gjendjeje të mëparshme me mjete të mëvonshme, domethënë, përdorimin e dheut, brigjeve të lumenjve, rrufesë e gjamës së valëve për të pikturuar tablonë fillestare të kaosit” (Kadare 2012: 185-186)¹.

Në fakt, Poeti (autori i dy oktavave në fjalë) është Ovidi (*Metamorphoseon libri*) dhe bëhet fjalë për oktavën e tretë dhe të katërt të përkthimit italisht nga Anguillara, *Le metamorfosi di Ouidio ridotte da Gio Andrea dell'Anguillara in ottava rima*, 1561)², sot jo dhe aq e njohur për kritikën, por që pati ‘fat’ të madh letrar mes shekujve XVI-XVII.

¹ Kadare I., (2012): f. 185-186: “Në strofën e parë është kaosi përpara krijimit. *Parëse Qiellja, Dheu, Deti e Zjarmi Ishte: kje Zjarmi, Dheu, Qiellja e Deti.*

E gjithë strofa prej tetë vargjesh jep gjithë pleksjen kaotike të këtyre katër elementeve në të gjitha bashkimet, ndarjet, fërkimet dhe ndeshjet e mundshme. Këtë poeti e bën në mënyrë përsëritëse, lodhëse, delirante, si për të krijuar te lexuesi atë ritëm mendimi që sjell një gjendje ethesh me temperaturë të lartë.

Në strofën e dytë gjithçka ndryshon. Lexuesi, si njeriu që sapo i ka rënë ethja, ka një vegim më të kthjellët. *Mbë Qiellt nuk ishte as Yll, as Dielli./ Qi me dritetë vet zbardhen dritë të re./ As Hana delte me dy të rgjante bri/ As prej qiellshit vinte ndonjë Reze përdhe./ As Dheu si Shqipe nalt qëndron e rri. / As niegullë me shi, as breshën, as Rëfe. As Deti me Valë epte të madhe gjamë, As lymenatë me Breg ishinë zanë.* Në këto vargje, përveç që ndiejmë gati fizikisht mundin e poetit, tek vërtitet, riparues i vetmuar në shkretinë e një tempulli, për të punuar me një gjuhë që po mpihet e drangët nën pluhurin aziatik.

Përveç vargut madhështor: *As Deti me valë epte të madhe gjamë*, ne gjejmë diçka tepër kureshtare: dhënien e një gjendjeje të mëparshme me mjete të mëvonshme, domethënë, përdorimin e dheut, brigjeve të lumenjve, rrufesë e gjamës së valëve (të gjitha këto të krijuara më pas), si edhe shqiponjën e brrin e argjenditë (të krijuara edhe më vonë), për të pikturuar tablonë fillestare të kaosit”.

² Ovidius Naso, P. & Orologi, G., Franco, G., Turchi, F. Anguillara, G. (1561): *Le metamorfosi di Ovidio ridotte da Gio Andrea dell'Anguillara in ottava rima: con le annotationi di M. Giosepe Horologi, & gli argomenti, & postille di M. Francesco Turchi.*




Ndonëse Ovidi përmendet dy herë në *Cuneus Prophetarum* (në mbyllje të fjalës hyrëse drejtuar lexuesit me librin 3 të Elegjive ([...] *posi tha Ovid*. Lib. 3. Elegia I), si dhe në XVIII, ku përdoret një figurë ovidiane (“[...] *ani me zemërë anëko, posi tha Ovid*”), si autor i *Metamorfozave* Ovidi nuk përmendet asnjëherë në veprën e Bogdanit.

Përdorimi i mitit ovidian të krijimit të rruzullimit është vendimtar për përmasën letrare që merr vepra në funksion të idesë bosht të saj, asaj të profecive për ndërthurjen më intime të veprës.

‘Kaosi’ ndodhet pikërisht në fillim të veprës *Metamorfozat*, dhe në mënyrë mjaft origjinale, mbizotëron përshkrimi i rruzullimit si një masë “pa formë dhe e rrëmujshe” («*rudis indigestaque moles*), një grumbull elementesh pa rregull, “nji grumbull i pagdhendë pa


farë trajte”, siç lexojmë në përkthimin në shqip prej originalit të Henrik Lacajt¹.

Dy oktavat e veprës italisht *Metamorfozat* vendosen prej Anguillara-s nën paragrafin “Caos”, parafrazim i lirë i veprës së Ovidit:



¹ Publius Ovidius Naso *Metamorphosen libri*, tr. it. *Metamorfosi*, 1979, përkthyer shqip nga origjinali prej Henrik Lacajt “*Metamorfozat*”, Tiranë, Onufri, 1998: “*Ante mare et terrās et, quod tegit omnia caelum unus erat tōtō nātūrae vultus in orbe, quem dixēre Chaos, rudis indīgestaque mōlēs nec quicquam nisi pondus iners congestaque eōdem non bene iunctārum discordia sēmina rērum* (vv. 5-10)/ “Kur ende s’kishte det e tok’ e qiell/ që gjithësinë rrok, natyra tërë/ e bota mbarë s’ishte veç një Kaos,/ një grumbull i pagdhendë pa farë trajte,/ s’ish tjetër gjë veçse një peshë e ngathët/ ku farët e çdo sendi po qëndronin/ pa asnjë pajtim dhe të bashkuar keqas.”

Oktava 2



Pohimit të Sedajt (Sedaj 1991: 129) se përkthimi i Bogdanit është i lirë dhe jo shumë besnik, i shtohet detaji se përshtatja e Anguillara-s largohet nga varianti latinisht i origjinalit.

Duke përdorur përkthimin besnik në shqip të veprës së Ovidit *Metamorfozat* prej Lacajt, le të hetojmë kalimin e domethënies nga gjuha/bota kulturore italiane në atë shqiptare në realizimin e modelit biblik të Zanafillës (Gjenezës) së Bogdanit.

Ky përshkrim i pamjes së botës në “Zanafillë”, fill pas krijimit nga Zoti, kryhet nëpërmjet përshkrimit të asaj që ishte pamja e botës, ende në fazë përsosjeje:

“Come Dio creò il cielo” (I, IV.4)	“Si e krijoi Zotynë qiellnë” (I, IV.4)
1. Pria che il ciel fosse il Mar, la Terra, e il Foco,	1. Parë se qiellja, dheu, deti e zjarmi
2. Era il Foco, la Terra il ciel, e' il mare,	2. Ishte, kje zjarmi, dheu, qiellja e deti;
3. Ma il Mar rendeva il Ciel, la Terra, e' il Foco	3. Ma shempton qiellja dhenë e detinë zjarmi,

4. Defforme: il Foco, il Ciel, la Terra, e' l Mare, 5. Che ivi era e Terra, e Ciel, e Mare, e Foco, 6. Dove era e Cielo, e Terra, e Foco, e Mare, 7. La terra il Foco, e il Mare era nel Cielo, 8. Nel Mar il Foco, e nella Terra il Cielo	4. Se ku ish qiellja, dheu, zjarmi e deti, 5. Aty ish dheu, qiellja, deti e zjarmi: 6. Dheu qiellnë mbëlon e zjarminë deti, 7. Qiellja, deti ende zjarmi ishte ndë dhet, 8. Dheu zjarmi ende qiellja ishte ndë det.
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

“Kaosi, një të përziem”, përshtuar prej Ovidit si paraekzistues i krijimit ishte pamja *confuso*/ “të përziem” e rruzullimit para se “Një Perëndi dhe një natyrë më e mirë e zhduku këtë luftë” dhe ndërfutet në veprën e Bogdanit pikërisht për të kundërshtuar mënyrën e vështrimit të *pëganëve/ i Gentili*, të cilët shohin në “*Chaos/ një të përziemi*”, lëndën para Zotit.

Teksti shqip i oktavës së parë ndjek vetëm pjesërisht ndërtimin e tekstit italisht. Zgjedhja e Bogdanit përputhet me Anguillara-n vetëm në figurën e parë: ajo e përzierjes dhe e kacafytjes së elementeve të kohës mbrapa me kohën përpara krijimit, dhënë në të dyja gjuhët me dy çifte kohësh foljore që grinden mes tyre: ishte/ “era” vs. “fosse”/ “kje”.

Pas kontrastit, uniformiteti i pamjes së krijimit (“unico e indistinto”) i “njëtrajtshëm dhe i pandarë” i lëndës në kaos, (vv. 4-6), që jepet, përkatësisht në italisht me lidhëzën “e”, *e terra e ciel e mare e foco*, realizohet në shqip me një zgjedhje disi më të ndërlikuar dhe me dy vargje, pa përdorimin e lidhëzës: aty përshtohen elementet e Kaosit (“det”, “tokë”, “zjarr”, “qiell”) duke u përqendruar në kontrastin mes tyre sipas një skeme në figurë kjazmi mes vargjeve 3 dhe 6: «qiell» vs. «tokë», dhe «zjarr» vs. «det» të vargut 3. («*Ma shempton qiellja dhenë e detinë zjarmi*»), elemente të cilat përmbysen në vargun 6, ku është “toka” që ‘mbulon’ «qiellin» dhe «deti» që mbulon «zjarrin» («*Dheu qiellnë mbëlon e zjarminë deti*»).

Kjo vendosje e elementeve mungon në tekstin italisht, ku është vetëm elementi “mar” që shformon (‘deforma’) tre të tjerët (“Ciel”, “Terra”, “fuoco”): “3. *Ma il Mar rendeva il Ciel, la Terra, e' l Foco/4. Defforme*”.

Mund të hipotizojmë se teksti shqip mund të jetë ushqyer nga

domethënia e vargjeve të mëpasme të origjinalit të Ovidit (15-20), që i rreshton elementet e krijimit në një rend natyror anulimi reciprok, shuarje, konflikti:

<p>15. <i>utque erat et tellūs illic et pontus et aēr, sic erat instabilis tellūs, innābilis unda, lūcis egens aēr: nullī sua forma manēbat, obstābatque aliīs aliud, quia corpore in ūnō frīgida pugnābant calidīs, ūmentia siccīs,</i> 20. <i>mollia cum dūrīs, sine pondere habentia pondus</i> Met. vv. 15-21</p>	<p>15. ujët të palundrueshëm, ashtu ajri ish i padritë, çdo gjë ishte e patrajtë;/ sendet në kundërshtim ishin mes tyre,/ sepse n'të njëjtin trup luftonin bashkë/ të ftohtit me të ngrohtit, lagështira/ me thatësinë, e buta me të fortën/ dhe gjëja e lehtë luftonte me të rëndën. (Met. përkth. Lacaj)</p>
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Aspekti i formës në bazë të kombinimit të elementeve vërehet edhe nga lidhja ndërtekstore mes zërit *shempton*, përdorur për të dhënë në shqip fjalën *defforme* të vargut 4 («*Ma il Mar rendeva il Ciel, la Terra, e' l Foco/Defforme*»)/3. *Ma shempton qiellja dhenë e detinë zjarmi*) me fjalën e shenjës semantikisht të kundërt, *mbukuruem*, referuar në paragrafin pararendës, gjësë së kryer (*formata*) dhe sjellë në shqip me dy fjalë, *mbaruem* e *mbukuruem*: «*ma non per questo ogni cosa nel suo luogo, e specie formata restò*»/Ma jo prashtu gjithë kafsha mbet *mbaruem* e *mbukuruem*».

Përshkrimi i krijimit si “formë” “e bukur” e afron doktrinën kristiane bogdaniane të krijimit me atë të Dantes së “Convivio-s”, apo të *Komedisë*, ku flitet për “krijuesin” (l’artefice) që “aq bukuri krijon në lëndën (natyrën) e tij (*dare l’artefice, cioè la natura umana, che tanta bellezza produce ne la sua materia*)¹, apo Dantes së *Komedisë* që flet për “cose belle”².

Analiza e oktavës së parë tregon se mund të krijohet një telajo intime e veprës që përqendrohet në përmasën estetike, pra simbolikisht për një poetikë artistike si element unifikues i krijimit dhe që tejkalon si rrafshin biblik, ashtu dhe atë mitologjik të Ovidit.

¹ Dante: Convivio III.IV.7: «E così non dovemo lodare l’uomo per biltate che abbia da sua nativitate ne lo suo corpo, ché non fu ello di ciò fattore, ma dovemo lodare l’artefice, cioè la natura umana, che tanta bellezza produce ne la sua materia quando impedita da essa non è».

² *Commedia* Inf. XXXIV, 137-139: “...salimmo sù, el primo e io secondo,/ tanto ch’i’ vidi de le cose belle/che porta ’l ciel, per un pertugio tondo./ E quindi uscimmo a riveder le stelle».

Oktava e dytë, gjithnjë në kontrast, numëron të gjitha ato krijime që nuk ishin para kryerjes nga vepra hyjnore, ndërton botën e mëpasshme që mungonte ende në momentin e boshllëkut të krijimit.

Versioni shqip i oktavës së dytë largohet më shumë nga versioni italisht, duke përdorur fjalë që i shtojnë skenës subjektivitetin e unit krijues.

Scala I, Discorso IV “Come Dio creò il cielo”	Ovidi- Bogdani: Oktava II (transkriptim i tekstit shqip A. Omari)
1. Non vi era chi portasse il nuovo giorno, 2. Con maggior lume in Oriente acceso, 3. Né rinovava mai la luna il corno, 4. Ne l’altre Stelle havean lor corso preso, 5. Ne pendeva la Terra intorno intorno, 6. Librata ina Aere dal suo proprio peso: 7. Ne il Mar havea col suo proprio grido, 8. Fatto intorno la Terra il vario lido	1. Mbë qiellt nuk’ ishte as yll as diellī 2. Qi me dritë të vet zbardhën dritë të re 3. As hana delte me dy të rgjanta brij, 4. As prej qiellshit vinte ndonji rreze për dhë, 5. As dheu si shqype nalt qëndron e rrij, 6. As negullë me shī, as breshën’ as rrefe 7. As deti me valë epte të madhe gjamë, 8. As lymënatë me breg ishinë zanë

Versioni italisht i Anguillara-s u referohet të gjitha elementeve që origjinali i Ovidit në vv. 20-25 i rreshton në një hierarki vertikale: qiell, zjarr, dritë, ajër, tokë, sistemim i realizuar nga një “perëndi dhe natyrë më e mirë”¹.

Në dy vargjet e para vërehet përkthimi i «oriente acceso» me shprehjen *zbardhën dritë të re*, zgjedhje leksikore që i jep një farë dinamiciteti vështrimit të unit poetik, që nga toka duket se vështron horizontin (*Non vi era chi portasse il nuovo giorno, / Con maggior lume in Oriente acceso // Mbë qiellt nuk’ ishte as yll as diell / Qi me dritë të vet zbardhën dritë të re*”).

Figura “dritë të re” sugjeron një zgjedhje që del nga konteksti i vargjeve të Anguillara-s, dhe nëse do ta qasnim me një agim tjetër të

¹ *Hanc deus et melior litem natura diremit; / nam caelo terras et terris abscidit undas / et liquidum spisso secrevit ab aere caelum.* // “Një perëndi dhe një natyrë më e mirë/ e zhduku këtë luftë, sepse e shkëputi tokën nga qielli dhe nga toka ujin dhe ajrin e kulluar e veçoi nga ajri i dendur” (Ovidio, Met. Lib.I, 21-24, përkth. shqip H. Lacaj).

famshëm kujton fjalën “albore” që Dante përdor në *Il Convivio*, për të shënuar një tufë drite që zgjatet e bardhë mes dy poleve të yjve të palëvizshme (*albore lo quale noi chiamiamo galassia*”, CV. II, XIV, 7), apo dritën që zbardhëllen («biancheggia») mes poleve të botës së *Komedisë*, (Par. XIV: 97-99).

Imazhi i hënës që përtërihet në vargun tre (3) italisht («Né rinovava mai la luna il corno»), përkthehet në shqip me imazhin e një hëne që në mënyrë dinamike “delte” me dy “të rëgjanta brij” («*As hana delte me dy të rjanta brij*», v. 3). Ngjyra e hënës i shtohet skenës dinamike të realizuar nga folja “dal”, duke kujtuar apo cituar në mënyrë të nënkuptuar ngjyrën e hënës te Dante, që e përshkruan si “pasqyrë” që fsheh plumbin përmbra vetes.

Vargu 4 (“*Ne l’altre Stelle havean lor corso preso*”) interpretohet nga Bogdani me një imazh që largohet nga trajektorja e yjeve të Ovidit dhe përqendrohet te “rrezja” (4. *As prej qiellshit vinte ndonji rreze për dhë*“): edhe koncepti i “rrezes” gjen te Dantja një përdorim si simbol i virtutit të Zotit, të inteligjencës së krijuesit, që rrezaton “rrezën” e “dritës hyjnore”. (Cv. II.VI 4-5).

Në një univers kulturor të saktë na çon edhe përkthimi i vargjeve 5-6 të Ovidit, ku përshkruhet imazhi i tokës pezull me eterin e dendësuar përreth (*Ne pendeva la Terra intorno intorno, / Librata ina Aere dal suo proprio peso*), sjellë nga Bogdani vetëm me një varg, me imazhin e tokës që rri pezull si shqipe: «*As dheu si shqype nalt qëndron e rrij*».

Lidhur me temën qëndrore të veprës, atë të profecive, imazhi i përshkruar nga Bogdani plotëson kuadrin e krijimit akoma në fazë përsosjeje, pra, pezull, ende i pakryer, por pjesë e ‘vizionit’ hyjnor, si figura e shqiponjës në ëndrrën profetike të Dantes, pezull, prodhim i një “mendjeje”, “profete e vizioneve të saj” («*mente*» *profeta che «a le sue vision quasi è divina*») (cfr. Pg. 13-23¹).

Vargu i gjashtë (6), i ndryshëm prej versionit italisht, u referohet fenomeneve klimatike (*As niegullë me shi, as breshën’ as*

¹ *Commedia* Pg. 13-23: “Ne l’ora che comincia i tristi lai/la rondinella presso a la mattina,/forse a memoria de’ suo’ primi guai, / e che la mente nostra, peregrina/più da la carne e men da’ pensier presa,/a le sue vision quasi è divina,/ in sogno mi parea veder sospesa/un’aguglia nel ciel con penne d’oro,/con l’ali aperte e a calare intesa; 21//ed esser mi parea làlove fuoro/abbandonati i suoi da Ganimede,/quando fu ratto al sommo consistoro”.

rrefe): Bogdani ndërton në shqip imazhin e kufirit që ndan ujin nga toka, duke shtuar nga fjalë dhe imazhe të marra nga Ovidi në vargjet e mëpasme [oktava, 13 Anguillara] apo origjinali i Ovidit në latinisht që po e japim (54-56) të përkthyer nga Lacaj:

Illic et nebulas, illic consistere nubes/ iussit, et humanas motura tonitrua mentes/ et cum fulminibus facientes fulgora ventos.”// Aty dha urdhër t’rrinin/ dhe mjegull, edhe re e bubullima/ që zemrën ia lëndojnë njerëzimit/ dhe erërat gjithë shqotë dhe rrufe”.¹

Siç shihet, receptimi vetjak i tekstit të Kaosit të Ovidit duket se është rezultat i një teksti tjetër burimor dhe i paraprin shkrimin të “Çetës”: dinamikat mes shkaqeve dhe zanafillës, mes krijuesit dhe krijimit na shfaqin përpara sysh një Bogdan –poet, kur i qaset temave profetike të krijimit të Botës.

Konsiderata e parë që mund të bëhet duke vëzhguar fragmentet në shqip dhe italisht, është pohim i asaj që ka vërejtur kritika se Bogdani i kishte përpunuar fillimisht në shqip këto vargje, me një trajtë të shtresëzuar gjuhësore, që flet për një burim të ndryshëm prej burimit të Anguillara-s (ndoshta origjinalit të Ovidit).

3. Ovidi dhe Dante në telajo të veprës

Megjithëse nuk përmendet në mënyrë të drejtpërdrejtë, Ovidi e imazhet e tij mitologjike janë pikë referimi konstante në veprën e Bogdanit: në shkallën I, Ligj V, kur përmend nën termin “fingere”/ *cpif* që është e kundërta e “krijimit”, i referohet pikërisht mitit ovidian të bartjes së qiellit mbi shpatullat e Atlantit: “*posi e cpifinë poetëtë tanë, se aj mbë krahë~të vet mba qielltë*”, (I 34 10).

Në këtë trajektore poetike, rëndësia e burimit letrar të imazheve të Ovidit dëshmohet gjithashtu në një fragment të Ligjëratës VI, shkalla e parë (I.VI.4), për të ndërtuar skenën më të rëndësishme të “Krijimit”, atë të njeriut, dhe urdhrit për të parë lart dhe rrokur jyet, si mundësi e tij për të rrokur Zotin: dhe Bogdani përdor vargun

¹ Ovidio: Met. Lib 1: 54-56; përkth. shqip H. Lacaj: *Illic et nebulas, illic consistere nubes/ iussit, et humanas motura tonitrua mentes/ et cum fulminibus facientes fulgora ventos.”// Aty dha urdhër t’rrinin/ dhe mjegull, edhe re e bubullima/ që zemrën ia lëndojnë njerëzimit/ dhe erërat gjithë shqotë dhe rrufe”.*

85 të librit të parë të *Metamorfozave* në latinisht, duke cituar sërish pa emër “il Poeta”

(Creo Dio il corpo humano col capo ereto verso il cielo, come dice il poeta// Krijoi Hyji shtatn’e njerit me faqe malt prej qiellshit possi thotë poeta. «*Os homini Sublime dedit, Caelumque videre jussiti/ Faqe nierit të naltë i dha, e qiellnë me soditunë i urdhënoj*», I.VI.4).

Në “nevojën” që imponon ideja poetike në telajon e veprës, është imazhi i Ovidit që i përgjigjet përmasës artistike të veprës (“*Ndërsa të tjerë frymorë,/Përkulë shikojnë përdhe, njeriut iu dha/ Fytyra e ngritur edhe mori urdhër/ Të shihte n’qiell dhe t’i drejtonte sytë/ lart e më lart, deri atje lart tek yjet*”)¹ dhe jo vargu i Gjenezës biblike: Zanafilla 15: 5 (*Pastaj e çoi jashtë dhe i tha: « Vështro me kujdes qiellin dhe numëro yjet, në rast se mund t’i numërosh, pastaj shtoi: Kështu kanë për të qenë pasardhësit e tu*»²).

Edhe në këtë rast mund të flitet për një prirje poetike dhe receptim të përmasës poetiko-filozofike të teksteve të Dantes, i cili ka një pasion të madh për krijimin të cilin e përçqas me gjërat e bukura: në fakt i mbyll dy kantikat e para duke përpunuar vargun e Ovidit me imazhin e njeriut që sheh yjet: “... salimmo sù, el primo e io secondo,/ tanto ch’i’ vidi de le cose belle/^[SEP]che porta ’l ciel, per un pertugio tondo./ E quindi uscimmo a riveder le stelle” (*Inf. XXXIV: 137-139*); «puro e disposto a salire a le stelle», (*Purg. XXXIII: 145*).

Megjithëse i udhëhequr nga doktrina kristiane, vepra e Dantes është e mbushur me fragmente dhe figura që flasin për një lexim të kujdesshëm të miteve ovidiane dhe vlerës së tyre alegorike. Siç do të shprehet Paratore, Dante i përdor *Metamorfozat* si vepra që mbulojnë të vërteta të larta (“*opera adombrante le supreme verità*” (Paratore 1970).

Gjuha e Dantes është e paevitueshme për një vepër si ajo e Bogdanit, pasi Dante, në sendërtimin alegorik të procesit të

¹ Po aty, vv: 84-86: “pronaque cum spectent animalia cetera terram./ os homini sublime dedit caelumque videre/ iussit et erectos ad sidera tollere vultus.”// “*Ndërsa të tjerë frymorë,/Përkulë shikojnë përdhe, njeriut iu dha/ Fytyra e ngritur edhe mori urdhër/ Të shihte n’qiell dhe t’i drejtonte sytë/ lart e më lart, deri atje lart tek yjet*”.

² <http://krishterimi.al>

shëlbimit, e përshkruan veten si profet dhe veprën e tij si sendërtuese të profecisë.

Ndonëse të futura në vepër për të përmbysur mendimin e paganëve, forca e imazheve ovidiane të përcjella nëpërmjet gjuhës së Dantes, interpretuesit më të mirë të Ovidit në traditën e shkrimit italisht, i japin veprës një përmasë të theksuar humaniste.

Dashuria për njeriun krijuar për parajsën (*Creata per il Paradiso, qual consiste nel vedere Dio*) (I.VI.4), dhe për filozofinë («L'amore della filosofia»/«te dashunitë Filosofisë», I.I.IV.41) shoqëron të gjithë përshkrimin bogdania të kozmosit, tregues i një individualiteti poetik shumë të spikatur.

Dante, pavarësisht mungesës së citimit të drejtpërdrejtë, është i pranishëm në gjuhën e Bogdanit dhe ngjyros me një profil poetik përshkrimin e krijimit të rruzullimit në të gjitha fazat e tij. Nuk është e rastësishme që pavarësisht burimit të panjohur ovidian, një studiues si Uçi, në “Dante Alighieri in Albania”, sheh në përshkrimin e kozmogonisë prej Bogdanit pikërisht gjurmë të vargjeve danteske të Parajsës (Uçi 2012: 74-75).

Nevoja e sqarimit të ‘paqartësisë’ mes “generare” (“fare”) dhe “creare”, akt ekskluziv i Zotit, si lindjes nga hiçi (“far nascere dal nulla”) e gjejmë edhe në veprat e Dantes *Commedia*, por edhe *Convivio*: “[...] questi tre ordini fanno la prima gerarchia: non prima quanto a nobiltade, non a creazione (ché più sono l’altre nobili e tutte furono insieme create”, Cv. II v. 6; “L’animo, ch’è creato ad amar presto,/ ad ogne cosa è mobile che piace” (Pg XVIII 19); “Lo maggior don che Dio per sua larghezza/ fesse creando” (Pd v. 20).

Gjithashtu, në *Il Convivio* Dante distancohet nga paganët «li gentili, cioè pagani» (in CV.IV.XXIII.14) dhe e vetmja herë që përdor fjalën “caòsso” e bën në një kontekst të ndërtuar për të përshkruar dashurinë e Zotit për krijimin (“La profonda orribile valle dell’Inferno/ tremò sì, ch’i’ pensai che l’universo/ sentisse amor, per lo qual è chi creda/ più volte il mondo in caòsso converso”, *Inf XII.43*).

Që Bogdani ka njohur burimin dantesk të kaosit, si akt dashurie të Zotit për krijimin, mund të supozohet edhe nga një tjetër fragment i *Cuneus-it*, ku përdoret koncepti i kaosit (*Chaos* “të përzieme”) kushtuar sibilës *Frigia*, kur parashikon pamjen e tokës së

transformuar në ferrin e kaosit, pas dëgjimit të “suono d’amore” della voce del cielo/ *nji zaa të përmallshëm*:

“Boria prej qiellshit *nji zā* të përmallshim ka me shtëm. E të përzieme të Ferrit ka me kallëzue, tu i përpim dheu: kanë me ardhunë përpara Tinëzot gjithë regjënjtë.” (Sibilla Frigia: IV.X.3).

Të tjera figura të pranishme në veprën *Cuneus prophetarum* të çojnë në veprën e Dantes dhe mitin qendror krijimit: Rugova ka folur për strukturën danteske të qiejve në veprën e Bogdanit.¹

Temat e profecive të cilat përdorin, edhe tema të tjera të trajtuara gjerësisht në historinë e shkrimit perëndimor si ai i krijimit të rruzullimit, veç traditës përkatëse bartin, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të nënkuptuar, italishten e kohës, e cila për këto tema mbart vulën e Dantes: tekstet françeskane në gjuhë vulgare kanë parë te Dantja një shembull prestigjioz të gjuhës letrare.

Koncepti i gjuhës vulgare si burim i letërsisë religjioze të nënkuptuar si “prodhim poetik”, ishte një koncept familjar i prodhimit françeskan.

Rugova, në përcaktimin e figurës së Bogdanit si “Racionalisti. Humanisti. Panteisti”, e konsideron veprën si një *Komedi hyjnore* shqiptare, konsideruar në rrafsh aksiologjik, filozofik dhe historiko-letrar, produkt të një botëkuptimi “teologjik panteist”².

Ndonëse mund të duket i tepruar një përcaktim i tillë për veprën e Bogdanit, lindur në kontekst dhe me miratim të kishës së Romës, rrezatim i funksionit që krijon natyra dinamike e tekstit (kushtëzuar nga kalimi prej një gjuhe në tjetrën dhe nga një

¹ Rugova I. (1982), f. 213: “Në ligjëratën IV të shkallës I ku flitet për krijimin e qiellit (Kozmosit), jep gravurën ilustruese mbi rrahët e qiellit, kozmosit, që janë dymbëdhjetë, si duket simbas veprës së Dantes, sepse Kisha numëronte më pak. Këtu jepen qiejt (rrahët) dhe planetet, të cilat i shqyrton në tekst. Mbas kësaj gravure vjen një skicë, ku ilustrohet të zënë e Diellit dhe tjetra ku paraqitet të zënit e hënës. Të dyja kanë karakter ilustrues shkencor. Një gravurë e ngjashme jepet në ligjëratën V të kësaj shkalle, që ilustron sistemin e rrahëve të Tokës (Rrethi i shekullit) ndarë në dymbëdhjetë rrahë simbas Dantes”.

² Po aty, f. 226: “Racionalist sepse si çështje kryesore për njohjen e përgjithshme të zotit, të botës e të njeriut e merr Mendjen, Arsyen. [...] Themi se është humanist, sepse në qendër të veprës e ka njeriun dhe për të vazhdimisht flet me dhimbje edhe adhurim. Dhe ky është edhe koncepti i filozofisë teologjike, por këtë e pasuron me kërkesën për racionalizmin dhe fizikën e tij në këtë botë, e që me botën tjetër lidhet me shpirtin e tij. Kjo është çështje e lidhur me botëkuptimin e tij teologjik panteist”.

regjistër te tjetri, brenda së njëjtës gjuhë) i jep shkas funksionit ‘shtesë’, polisens të veprës artistike që me realizimin e “krijimit” të universit, pohon idenë moderne të krijimit të njeriut.

Dinamikat mes shkaqeve dhe zanafillës, mes krijuesit dhe krijimit na shfaqin përpara sysh një Bogdan -poet kur u qaset temave profetike të krijimit të Botës.

4. Konsiderata për terrenin fluid të tekstit dygjuhësh dhe mitin mesdhetar të ‘kthimit’

Me ambicien për krijimin e një gjuhe “letrare mbirajonale” (Omari 2016: 11), Bogdani vetë shprehet për një rrugë të mesme në operacionin e tij dygjuhësh: në njërën anë, në Padovën që i lejonte mundësinë e përdorimit të italishtes së përpunuar të kohës dhe nga ana tjetër, përballë vështirësisë me shqipen “e gjymtë/ të paktë” për të shprehur nocione abstrakte.

Në analogji me Ovidin e librit 3 të *Elegjive*, Bogdani e sheh vendin e tij nën Turqinë si “të huaj” dhe veten si shkrimtar i “huaj” (*esuliat*): “Nëse qëllon që këto vargje nuk tingëllojnë latinisht, dheu ku i shkrova që dhe i huaj”:

Të lutemi pra letërrari em i urti të më ndëjejshtë ndë gjeç fjalëzë qi të trazon veshëtë. Përse as dielli pā hie, as hana pa niegullazë mbë faqe nukë është; po venë roe se kush na ka pushtuem e ndë të kujët dhë jemi, ani me zemërë anëko, posi tha Ovid. lib. 3. Elegia 1: Si qua videbuntur casu non dicta latine,

In qua scribebam, barbara terra fuit.

Mjegulla tëhuajtësuese dhe amorfe (kaosi simbolik i krijimit) përfshin konceptin bogdanian të krijimit në një gjuhë të pamësuar me tema teologjike, siç është nevoja e shëlbesës nga ‘ekzili’ i jetës prej vdekatarit: rruga e shpëtimit, të tij dhe të fjalës, konceptohet prej Bogdanit sipas traditës më të mirë kristiane, si një rrugë shkrimi që do të përshkruajë rregullin që fryma e Zotit krijon te njeriu, duke e larguar kështu nga kushtet tokësore të jetës së tij: “à noi “*esuliat*” in *hoc lacrimarum Valle*”:

“ashtu ende për të mos lanë neve t’huejve ndë këtë jetë plot me lot me pam qiellnë e Empireit / “à noi anche esuliati in hac lacrimarum Valle la vista del Cielo empireo”, (I.I.IV.23).

Mundi krijues i Bogdanit, nga gjetja dhe funksionalizimi i fjalëve të vjetra për futjen e koncepteve të reja, mund të konsiderohet si një version shqiptar i mitit mesdhetar të “kthimit”, jo vetëm metaforik në gjuhën, kulturën dhe fenë e të parëve.

Hapësira simbolike dhe mitologjike e mitit të krijimit, shembulli më origjinal i rikuperimit të identitetit mesdhetar evropian të shqipes, krijohet në veprën e Bogdanit falë një terreni jo të ngurtë, por bashkëveprues mes teksteve shqipe dhe italishte.

Kuptimet e reja shtesë të tekstit shqip nuk janë aq fryt i një akti të thjeshtë gjuhësor, por një proces i ndërlikuar interference që përfshin vizionin e vet autorit, i cili vë në shërbim të poetikës së tij të dyja gjuhët, të dyja tekstet, në bashkëveprim mes tyre.

Siç kemi vërejtur në analiza të tjera kushtuar veprës së Bogdanit (Suta B.: 2022) apo De Radës (Suta B.: 2019), ajo që na intereson në raportin mes dy teksteve, atij shqip dhe atij italisht, nuk lidhet dhe aq me ekuivalencën mes termave sesa me dallimin mes tyre, sipas konceptit të “interferencës” të Gusmani-t, “procesi nëpërmjet të cilit dy kode gjuhësore të ndryshme mbishtresohen dhe ndërthuren në aktin gjuhësor të një individi”, duke promovuar daljen në pah të “teknikave” dhe “vlerave të reja kulturore” (Gusmani 1981-2020: 245).

Kjo praktikë, siç shihet në rastin e Bogdanit, është treguese e natyrës bashkëplotësuese mes dy sistemeve semantike në rrafsh të kontekstualitetit organik dhe polisens (Della Volpe 1966: 100¹) të një ideje poetike që mban bashkuar në një tension të vetëm poetik pjesët e ndryshme të veprës.

¹ Della Volpe (1966): f. 100: “La poesia non può essere prigioniera della lingua- il pensiero (l'universale) resta *il fine* e la lingua è sempre il mezzo (un mezzo, propriamente); onde la poesia degna del nome sempre traducibile- lo è (intraducibile) solo nel senso divinato da Goethe- e cioè per l'ordine sintattico, discorsivo, "prosastico" che è il solo adeguato alla sua natura di discorso, sia pur polisenso- resta in conclusione di intraducibile o "ineffabile" non essa poesia ma solo la sua eufonia, che non può di massima aver alcun doppione esatto proprio per la sua dipendenza dal piano fonico o del *significante*, arbitrario e accidentale, e quindi mutevole da un sistema semantico all'altro.”

Orientimi i domethënies në rastin e veprës dygjuhëshe nuk vjen si pasojë e kalimit nga njëri sistem semantik te tjetri, por nga bashkimi dhe ndërmarrëdhënia e dy teksteve nën poetikën përbashkuese të autorit të veprës.

Kjo analizë na çon të hipotizojmë një nivel të dyfishtë të operacionit përkthimor të Bogdanit: ai i pari, që ka të bëjë me nivelin e dijeve shkencore dhe të doktrinës, interpretimi i të cilit vjen nga italishtja në shqip, dhe një nivel të dytë, ai më thellësisht filozofik dhe poetik, që funksionon në strukturë të mëvetësishme në shqip dhe ecën në një binar paralel dhe ndërveprues me atë italisht.

Studiuesit kanë përmendur efikasitetin e dygjuhësisë te Bogdani dhe një përpjekje për rritje të shqipes në kontakt me italishten (Sedaj), jo vetëm të termave teknikë dhe abstraktë, por edhe (sidomos) të shtresëzimit shprehës letrar (Camaj 1978).

Kontrastimi i varfërisë terminologjike të shqipes synon rrafshin më të lartë funksional, pikërisht në fragmentet letrare ku diferenca e teksteve shqipe dhe italishte (Anila Omari mbështet idenë se tekstet origjinale përputhen shpesh me atë shqip)¹, sugjerojnë një operacion leximi me drejtim të dyfishtë e përplotësues dhe zbulojnë në mënyrë më të qartë synimin gjuhësor të Bogdanit.

Si përfundim: letërsia dygjuhëshe, shqip dhe italisht, është pjesë e asaj tradite, që, në rrethana të ndryshme, është shfaqur në historinë e letrave shqipe si një përpjekje ndër më origjinalet për krijimin e një gjuhe të kultivuar.

Shfaqje origjinale e mitit të mërgimit të fjalës, dygjuhësia në veprën e Bogdanit, dhe pas tij te veprat e arbëreshëve De Rada (në dukje pa njohur veprën e Bogdanit), Santori e më pas Schiro-i (Camaj 1964: 334)², deri sot te Zef Schiro di Maggio, si dhe te poetët

¹ Omari A. (2015), f. 19: Por përqasjet me literaturën origjinale na qartësojnë edhe punën e autorit tonë, i cili e ka përshtatur në mënyrë krijuese lëndën e huaj, duke marrë në mënyrë përzgjedhëse faktet që i nevojiten, duke i shtjelluar në mënyrë të qartë e duke i ilustruar me shembuj qoftë nga autorë antikë, qoftë nga historia dhe jeta shqiptare, për t'iu afruar formimit dhe mendësisë së lexuesit shqiptar të cilit i drejtohet. Nga ana tjetër, me përjashtim të pjesëve mbi jetën e Sibilave dhe pjesërisht edhe të profetëve, versioni italisht i tekstit të Bogdanit, në ato pasazhe që kemi përqasur me veprat e literaturës origjinale, nuk përkon me botimet në italisht të këtyre veprave, por me tekstin e hartuar prej tij në shqipe, pra duket një përkthim besnik i tekstit shqip, ndonjëherë jo fort elegant [...]”.

² Camaj M. (1964), f. 334: “Santori, vetëdijshëm përpiket ta pasunojë gjuhën e së folmes së vet me huazime nga shqipja jonë. Nxjerr fjalë e forma nga autorët e vjetër gegë,

dygjuhësh të mërgimit të ri, si Gëzim Hajdari, Jonida Prifti etj., e tejkalon katërçipërisht procesin thjesht të kalimit apo përkthimit nga njëra gjuhë te tjetra dhe bëhet mjet për funksionimin e mekanizmit të ndërlikuar të strukturimit të veprës dhe pasurimit të saj me vlerat shtesë të veprës artistike.

Bogdani, iniciues i traditës së predikatorëve siç i quan Camaj, është i pari, por edhe më i veçanti në këtë pikëpamje, pasi bart, nëpërmjet praktikës dyfishe të përkthimit, idenë e tij 'letrare' për veprën në një poetikë unifikuese që shfaq gjurmë të prirjes artistike të shkrimtarit.

Pohimit të studiuesve të Bogdanit se autori ynë "e ka përshtatur në mënyrë krijuese lëndën e huaj" (Bogdani P. & Omari A. (2015: 19), falë "vetëdijes prej shkrimtari" (Ismajli 2000)¹, mund t'i shtojmë përfundimin se prania e burimeve të mitologjisë mesdhetare në veprën e Bogdanit e dëshmon atë si një nga shembujt më të frytshëm të takimit të shqipes letrare me kulturat e Mesdheut në hapësirën e letërsisë dygjuhëshe.

Bibliografia

Alighieri, D., & Chiavacci Leonardi, A. (2005): *La divina Commedia*, Oscar Mondadori: Milano.

Banfi Emanuele, (ed digitale 2015): *Lingue d'Italia fuori d'Italia Europa, Mediterraneo e Levante dal Medioevo all'età moderna*, Il Mulino, Bologna

Bogdani P. & Camaj (1977): *Cuneus prophetarum a Pietro Bogdano, Patavii MDCLXXXV*, R. Trofenik, München, 1977 (= Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahen Orients, Band 24].

Bogdani & E. Sedaj (1998) (përg.), *Pjetër Bogdani "Çeta e Profetëve" I (Cuneus Prophetarum)*, transliterimi në gjuhën e sotme, përkthimet dhe parathënia nga dr. E. Sedaj, "Rilindja", Prishtinë, 1989.

posaçe nga *Cuneus Prophetarum* i Bogdanit. [...] Ky "dell profesionisti" ashtë cilësi edhe e "Shkollës letrare shkodrane" të autorëve shqiptarë të shtitruem në letra klasike.”.

¹ Ismajli R. (2000), f. 291: "Vetëdija e tij prej shkrimtari manifestohej edhe në frazën e e gjatë racionale, me sintaksë nënrenditëse, me leksik të zgjedhur, me terma të shumtë, me përpjekje për të bërë diferencim të stileve, me citate të shumta, me drejtime te burimet e hershme të dijes, në prozë, me varg të punuar, me metër të ndryshuar jo thjesht popullor në poezi. Vepra e tij është më letrare, më elitariste dhe për lexues më të zgjedhur. Gjuha e Bogdanit është më pak popullore, më pak dialektalisht njësore, ndjeshëm më letrare, më koineizuese”.

Boitani, P. & Di Rocco E. (2013): Guida allo studio delle letterature comparate (Manuali di base) (Italian Edition) . Editori Laterza. Edizione e-book.

Sedaj E. (1977): *Pjetër Bogdani “Çeta e Profetëve” II (Jeta e Jezu Krishtit)*, transliterimi në gjuhën e sotme, hyrja, përkthimet dhe shënime nga dr. E. Sedaj, “Drita”, Prizren, 1977.

Bogdani P. & Omari A. (2015): *Cuneus Prophetarum (Çeta e Profetëve) 1685: botim kritik me një studim hyrës, faksimile të origjinalit, transkriptim e shënime, ribotim i përmirësuar*, Akademia e shkencave, Tiranë.

Camaj M. (1990): «Pjetër Bogdani, mjeshtër i gjuhës e i stilit», *Albanica*, 1, f. 80-81.

Camaj M. (1964): «Jeronim De Rada për gjuhësinë shqipe», *Shëjzat*, 7-10, f. 334-336.

Camaj M. (1965): «Purgatori e dyta kantikë e Komedisë Hyjnore në gjuhën shqipe», *Shëjzat* 8-10, f. 315-320.

Camaj M. (1995): «Letërsia arbëreshe në kontekstin evropian», *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare*. (Përmbledhje e ligjëratave dhe e kumtesave të lexuara në Seminaret XV e XVI, 1989-90), Universiteti i Prishtinës: Prishtinë, f. 60-72.

Camaj M. (2017): «Rrëmime mbi poezinë» (1991), *Vepra poetike*. Përgatiti për botim: Bardhyl Demiraj, Onufri: Tiranë, f. 6-7.

Della Volpe G. (1966): “Traducibilità dell'opera poetica”, *Critica del Gusto*, Feltrinelli: Milano.

Gusmani S. (1981-2020): *Saggi sull'interferenza linguistica*. Seconda edizione accresciuta, Firenze: Le Lettere.

Ismajli R. (2000) “Bogdani”, *Tekste të vjetra*, Dukagjini: Pejë.
Ismajli R. (2005): *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, ASHAAK: Tiranë.

Jorgaqi K. (2001): *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe (Shek. XVI-XVII)*, Botimet Toena: Tiranë.

Librandi R. (2012): *La letteratura religiosa*, Il Mulino: Bologna.

Kadare I (2012): *Ftesë në studio, botimi i tretë*, Onufri, Tiranë 2012.

Omari A. (2016): *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit. Fjalor i Cuneus Prophetarum me një konkordancë të pjesshme, i paraprirë nga një studim hyrës dhe kritere të fjalorit*, Qendra e studimeve albanologjike. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: Tiranë.

Omari A. (2020): “Kujdesi rilindas për gjuhën te shkrimtarët e shek. 17 - tipar i vetëdijes kombëtare dhe i prirjes iluministe”, *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2020, f. 56-64.

Ovidius Naso, P. & Calvino, I. Bernardini Marzolla, P. (1979): *Metamorphosen libri*, tr. it. *Metamorfosi*, Einaudi: Torino.

Ovidius Naso, P. & Orologi, G., Franco, G., Turchi, F. Anguillara, G. (1584): *Le metamorfosi di Ouidio ridotte da Gio Andrea dell'Anguillara in ottava rima: con le annotationi di M. Gioseppe Horologi, & gli argomenti, & postille di M. Francesco Turchi*, presso Bern. Giunti: Venezia.

Paratore E., (1970), Dante (di Ettore Paratore - "Ovidio": *Enciclopedia Dantesca* (1970): http://www.treccani.it/enciclopedia/publio-ovidio-nasone_%28Enciclopedia-Dantesca%29/):

Petrotta G. & Mandala M. (2003): *Popolo, lingua e letteratura albanese* (Palermo, 1931), a cura di Matteo Mandala, A. C. Mirror: Palermo.

Rugova I. (1982): *Vepra e Bogdanit 1675-1685. Cuneus Prophetarum*, Rilindja: Prishtinë.

Sedaj E. (1991): "Poezitë origjinale dhe të përkthyer të Pjetër Bogdanit", *Pjetër Bogdani dhe vepra e tij*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: Tiranë, f. 127-144.

Suta B. (2022), "La migrazione di termini e concetti in autori della tradizione letteraria bilingue italo-albanese: Pjetër Bogdani e Girolamo De Rada", in a cura di Mathias Heinz, Domenica Minniti Gònias, Luca Serianni, *Gli italianismi nel neogreco e i suoi dialetti e in altre lingue. Atti del Convegno "Italloelena. Incontri sulla lingua e la traduzione" (1 novembre 2019)*, Laboratorio di Lingua, Traduzione e studio del contatto linguistico italo-greco, Università Nazionale Capodistria di Atene, Atene 2022, pp. 145-163, ISBN: 978-960-466-268-5.

Suta B. (2019): Mërgimi i fjalës si 'mit' dhe evolucioni i shqipes letrare: rasti i poezisë dygjuhëshe ("La migrazione della parola come mito e l'evoluzione dell'albanese letterario: il caso della poesia bilingue"), in "Studime filologjike" 3-4 (LXXIII (LVI) 2019, Akademia e studimeve albanologjike. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 15-47

Suta B. (2015): "Dy letra të panjohura të De Radës drejtuar Manzoni-t: romantizmi deradian, një çështje e hapur", *Hylli i dritës*, 283-284, 180-208.

Uçi A. (2012), "Dante Alighieri in Albania", in *Da un secolo all'altro. Cento anni di storia d'Albania visti con gli occhi di un protagonista*, presentazione di Mario Brunetti, Collana Istituto, Mezzogiorno e Mediterraneo N. 11, Edizioni Orizzonti Meridionali, Cosenza 2012, f. 74-75

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve
Albanologjike / përgat. për bot. Shaban Sinani,
Pëllumb Xhufi ; red. Bruna Prifti. - Tiranë :
Akademia e Shkencave e Shqipërisë

V.III ; 16x23 cm.

V.III : Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve
Albanologjike. - 451 f. - Bibliogr.: .

ISBN 9789928809230

1.Albanologjia 2.Historia 3.Kongrese dhe kuvende
008(496.5) (062)
94(=18) (062)

